

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me Gjyqtarin Agim Kuçi dhe procesmbajtësen Ibadete Syla, në çështjen penale, kundër të pandehurit N. (F.) K., nga O., i akuzuar për shkak të veprës penale Sulm nga neni 187 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, me shenjën, PP.II.nr.5525/14 dt.26.01.2016, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e Urdhrit Ndëshkimorë, me dt.23.6.2017, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**PRANOHET** - Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.5525/14 dt.26.01.2016, kjo gjykatë jep këtë:

## URDHËR NDËSHKIMOR

**I pandehuri:** N. K., i biri i F., i lindur me datë *data e lindjes...*, në Zh., me vendbanim në rr. "...", p.n-O., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës,

## ËSHTË FAJTOR

**S e p s e:**

Me datë 19.01.2014, rreth orës 22:20, në O. në lokalit "S." i cili gjendet në rrugën "...", pasi që e ka thirrur tani të dëmtuarin R. H., që të del para lokalit dhe është fjalosur verbalisht me të, ka filluar ta godas me grushte në regjionin e kokës, me ç' rast i ka ndarë pronari i lokalit A. K., kurse i akuzuari ka vazhduar ta fyer tani të dëmtuarin R. H..

- Me këtë ka kryer veprën penale Sulm nga neni 187 par.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata konform nenit të sipërpërmendur dhe neneve 41, 43, 46, të KPRK, si dhe neneve 365 e 495, të KPP, të pandehurit i shqipton:

## DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 300 (treqind) €, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata në bazë të nenit 46 par 3 të KPRK, dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) € gjobë.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajë shumë aq sa do të bëhet sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 30 (tridhjetë) €.

Të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit me detyrim.

I dëmtuari: R. H. me vendbanim në lagjen "..."-O., për realizimin e kërkesës pasurore -juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko- civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën, PP.II.nr.5525/14 dt.26.01.2016, e ka akuzuar N. K., për shkak të veprës penale Sulm nga neni 187 par. 1 të KPRK-së, dhe njëherësh nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimorë, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri, vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPK, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, kallëzimi penal i dt.17.07.2014, si dhe shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.309/16, datë.23.6.2017

Procesmbajtësja  
Ibadete Syla

Gjyqtari  
Agim Kuçi

#### UDHËZIMI JURIDIK:

I pandehuri ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimorë, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.